



Pranimi / Dorezimi Priljepe / Priljepe Received / Delivery	06 - 04	2022	viti god year
Organ / Shënia Organ / Jednica Org. / Unit	By Prot Pr. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kohëzgjatësi Quantity
SKM8HCK	1928	2022	117



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.98/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari - kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën e datës 07.02.2022 me numër A.nr.98/2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi

Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit/Ministria e Shëndetësisë, në çështjen juridike-administrative "*kompensim material*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 06.04.2022, mori këtë:

### V E N D I M

I. Detyrohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë(15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të nxjerrë akt administrativ lidhur me kërkesën e datës 12.11.2021 të parashtruar nga ankuesi

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë, sipas akt emërimit me numër Nr.106 të datës 10.02.2012 në pozitën "*Asistent i Teknologjisë Informative*", me datën 07.02.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të Ministrisë së Shëndetësisë lidhur mos shqyrtimin e kërkesës së datës 12.11.2021 me numër protokolli 05-7285, për realizimin e të drejtës për kompensimin e pagesës për punë jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës dhe për kompensim të pagesës për punë jashtë orarit të rregullt gjatë fundjavës gjegjësisht mos zbatimin e nenit 20 paragrafit 1,

nen paragrafit 1.1 dhe nen paragrafit 1.2 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil dhe nenit 11 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 18.02.2022 e ka proceduar tek Ministria e Shëndetësisë kërkesën për përgjigje në ankesë, ndërsa Ministria e Shëndetësisë me datë 28.02.2022 ka pranuar përgjigjen se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 21.03.2022 ka nxjerrë Vendim me numër protokoli 1466/2022 për zgjatjen e afatit për vendimmarrje edhe për dhjetë (10) ditë pune, për ankesën me numër A.nr.98/2022 të datës 07.02.2022 sepse me date 15.03.2022 ka kërkuar prova shtese nga Ministria e Shëndetësisë, ndërsa me date 25.03.2022 Këshilli ka pranuar provat shtese.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:* Ankesën e datës 07.02.2022 me numër protokoli 571/2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 12.11.2021 për ekzekutim të pagesave nga ankuesja; Kërkesën nr. protokoli 05-8178 e datës 04.12.2020 për aprovimin e punëve gjatë ditëve të vikendit për regjistrimin e pikëve në sistemin elektronik për kandidatët që kanë fituar specializimin; E-maili zyrtar i datës 05.03.2021 për procedim të kompensimit sipas aprovimit të ZSP; E-maili zyrtar i datës 19.09.2020; Procesverbalin e datës 01.09.2020 lidhur me intervistën e kandidatëve për specializim; Procesverbalin e datës 01.09.2020 nga komisioni intervistues për kandidatët që kanë konkurruar për specializim; Procesverbalin e datës 19.09.2020 nga komisioni intervistues për kandidatët që kanë konkurruar për specializim; Përgatitja dhe shtypja e lëndëve për intervistë i datës 26.09.2020; Procesverbalin e datës 26.09.2020 lidhur me intervistën e kandidatëve për specializim; E-mail i datës 16.10.2020; E-mail i datës 06.11.2020; Përgatitja dhe shtypja e lëndëve për intervistë i datës 08.11.2020; Procesverbalin e datës 08.11.2020 nga përgatitja e kontratave dhe vendimet për kandidatët që kanë filluar specializimin; Përgatitja e kontratave dhe vendimet për kandidatët që kanë filluar specializimin e datë 07.11.2020; Procesverbalin e datës 07.11.2020 nga përgatitja e kontratave dhe vendimet për kandidatët që kanë filluar specializimin; E-mail i datës 21.11.2020; Mbledhje e komisionit e datës 21.11.2020; Mbledhje e komisionit për ankesa të shkallës së dytë e datë 20.11.2020; Mbledhje e komisionit për ankesa të shkallës së dytë e datë 22.11.2020 prej 1/10 faqe; E-mail i datës 23.10.2020; Regjistrimi i pikëve në sistem të kandidatëve që janë pranuar në specializim i datës 24.10.2020; Regjistrimi i pikëve në sistem të kandidatëve që janë pranuar në specializim i datës 25.10.2020; Procesverbalin e datës 25.10.2020 nga komisioni intervistues për kandidatët që kanë konkurruar për specializim; E-mail i datës 15.11.2020 Njoftim; E-mail i datës 06.11.2020 Njoftim; Përgatitja e kontratave dhe vendimeve për kandidatët që kanë fituar specializimin i datës 15.11.2020; Procesverbalin e datës 15.11.2020 nga përgatitja e kontratave dhe vendimet për kandidatët që kanë filluar specializimin; Përgatitja e kontratave dhe vendimeve për kandidatët që kanë fituar specializimin i datës 14.11.2020; Procesverbalin e datës 14.11.2020 nga përgatitja e kontratave dhe vendimet për kandidatët që kanë filluar specializimin; Përgatitja dhe shtypja e lëndëve për intervistë i datës 18.10.2020; Procesverbalin e datës 18.10.2020 nga komisioni për regjistrimin e pikëve për kandidatët që kanë konkurruar për specializimin; Përgatitja dhe shtypja e lëndëve për intervistë i datës 17.10.2020;

Procesverbalin e datës 17.10.2020 nga komisioni për regjistrimin e pikëve për kandidatët që kanë konkurruar për specializimin; Kërkesën e datës 12.11.2021 me nr. protokolli 05-7285 për ekzekutim të pagesave; Kërkesën e datës 01.10.2020 me nr. protokolli 05-6300 për aprovimin të komisionit për intervistës së kandidatëve për shkollim të specializantëve, gusht shtator 2020, bashkangjitur tabela me vlerën e pagesës për komisionin intervistues për kandidatët për shkollim të specializantëve gusht shtator 2020; Kërkesa e datës 05.11.2020 nr. protokolli 05-7354 për zbatimin e vendimit nr. protokolli 05-6300; E-mail i datës 04.02.2022; E-mail i datës 08.12.2020; Komisioni për intervistë të kandidateve i datë 01.09.2020; Procesverbalin e datës 01.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve që kanë konkurruar për specializimin; Komisioni për intervistë të kandidateve i datë 02.09.2020; Procesverbalin e datës 02.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve që kanë konkurruar për specializimin; Komisioni për intervistë të kandidateve i datë 03.09.2020; Procesverbalin e datës 03.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve që kanë konkurruar për specializimin; Komisioni për intervistë të kandidateve i datë 04.09.2020; Procesverbalin e datës 04.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve që kanë konkurruar për specializimin; Komisioni për intervistë të kandidateve i datë 07.09.2020; Procesverbalin e datës 07.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve që kanë konkurruar për specializimin; Komisioni për intervistë të kandidateve i datë 08.09.2020; Procesverbalin e datës 08.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve që kanë konkurruar për specializimin; Komisioni për intervistë të kandidateve i datë 09.09.2020; Procesverbalin e datës 09.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve që kanë konkurruar për specializimin; Komisioni për intervistë të kandidateve i datë 10.09.2020; Procesverbalin e datës 10.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve që kanë konkurruar për specializimin; Komisioni për intervistë të kandidateve i datë 11.09.2020; Procesverbalin e datës 11.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve që kanë konkurruar për specializimin; Komisioni për intervistë të kandidateve i datë 14.09.2020; Procesverbalin e datës 14.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve që kanë konkurruar për specializimin; Komisioni për intervistë të kandidateve i datë 15.09.2020; Procesverbalin e datës 19.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve që kanë konkurruar për specializimin; Komisioni për intervistë të kandidateve i datë 16.09.2020; Procesverbalin e datës 16.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve që kanë konkurruar për specializimin; Komisioni për intervistë të kandidateve i datë 17.09.2020; Procesverbalin e datës 17.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve që kanë konkurruar për specializimin; Komisioni për intervistë të kandidateve i datë 18.09.2020; Procesverbalin e datës 18.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve që kanë konkurruar për specializimin; Komisioni për intervistë të kandidateve i datë 21.09.2020; Procesverbalin e datës 21.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve që kanë konkurruar për specializimin; Komisioni për intervistë të kandidateve i datë 22.09.2020; Procesverbalin e datës 22.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve që kanë konkurruar për specializimin; Komisioni për intervistë të kandidateve i datë 23.09.2020; Procesverbalin e datës 23.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve që kanë konkurruar për specializimin; Komisioni për intervistë të kandidateve i datë 24.09.2020; Procesverbalin e datës 24.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve që kanë konkurruar për specializimin; Komisioni për intervistë të kandidateve i datë 25.09.2020; Procesverbalin e datës 25.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve që kanë konkurruar për specializimin; Komisioni për intervistë të kandidateve i datë 28.09.2020; Procesverbalin e datës 28.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve që kanë konkurruar për specializimin; Komisioni për

intervistë të kandidateve i datë 29.09.2020; Procesverbalin e datës 29.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve që kanë konkurruar për specializimin; Komisioni për intervistë të kandidateve i datë 30.09.2020; Procesverbalin e datës 30.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve që kanë konkurruar për specializimin; Komisioni për intervistë të kandidateve i datë 24.08.2020; Procesverbalin e datës 24.08.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve që kanë konkurruar për specializimin; Komisioni për intervistë të kandidateve i datë 25.08.2020; Procesverbalin e datës 25.08.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve që kanë konkurruar për specializimin; Komisioni për intervistë të kandidateve i datë 26.08.2020; Procesverbalin e datës 26.08.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve që kanë konkurruar për specializimin; Komisioni për intervistë të kandidateve i datë 27.08.2020; Procesverbalin e datës 27.08.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve që kanë konkurruar për specializimin; Komisioni për intervistë të kandidateve i datë 28.08.2020; Procesverbalin e datës 28.08.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve që kanë konkurruar për specializimin; Procesverbalin e datës 31.08.2020 nga komisioni intervistues kandidatëve që kanë konkurruar për specializimin; Procesverbalin e datës 28.08.2020 nga komisioni intervistues kandidatëve që kanë konkurruar për specializimin, bashkangjitur lista e kandidatëve dhe koha për intervista për konkursin e datës 30.07.2020, prej 1/42 faqe prej datë 24.08.2020 deri me datë 30.09.2020; Prova shtesë nga ankuesi të datës 18.03.2022 për mes E-mailit zyrtar, Kërkesa e datë 04.12.2020 me nr. protokollit 05-8178 për aprovimin e punës gjatë ditëve të vikendit për regjistrimin e pikëve në sitëm elektronike për kandidatët që kanë konkurruar për specializim; Komisioni për intervistë të kandidateve i datë 19.08.2020; Procesverbalin e datës 19.08.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve që kanë konkurruar për specializimin; Përgatitja dhe shtypja e lëndëve për intervistë i datës 26.09.2020; Procesverbalin e datës 26.09.2020 nga komisioni për regjistrimin e pikëve për kandidatët që kanë konkurruar për specializimin; E-mail i datës 18.01.2021 bashkangjitur listën e pagesës së komisionit intervistueses dhe kërkesë për korrigjim të pagesës për muajin nëntor, dhjetor 2020, për specializantët; E-mail i datës 15.1.2021 punë jashtë orari; Komisioni për korrigjimin e listave të specializantëve me subvencione i datës 15.01.2021; Komisioni për korrigjimin e listave të specializantëve me subvencione i datës 17.01.2021; Vendim nr. 05-126 i datës 12.01.2021 për korrigjimin e listave të specializantëve me subvencione, bashkangjitur lista e nëntorit, dhjetorit prej 1/26 faqe; E-maili i datës 06.11.2020, dërgua ankuesit për punë ditëve të vikendit me datë 07.11.2020 dhe 08.11.2020 jashtë orarit; Përgatitja e kontratave dhe vendimeve i datës 08.11.2020 për kandidatet që kanë konkurruar për specializim; Procesverbalin e datës 08.11.2020 për përgatitjen e kontratave dhe vendimeve për kandidatët që kanë konkurruar për specializimin; Përgatitja e kontratave dhe vendimeve i datës 07.11.2020 për kandidatet që kanë konkurruar për specializim; Procesverbalin e datës 07.11.2020 për përgatitjen e kontratave dhe vendimeve për kandidatët që kanë konkurruar për specializimin; E-mail i datës 21.11.2020 për punë ditëve të vikendit; mbledhja e komisionit për ankesa i datës 20.11.2020, i datës 21.11.2020, i datës 22.11.2020; E-mail i datës 23.10.2020 njoftim për punë gjatë vikendit; E-mail i datës 15.11.2020 njoftim për punë gjatë vikendit; Përgjigje në ankesë e datës 28.02.2022 nr. protokollit 1041/2022 për KPMSHKC-së, me shkresat e bashkangjitura: Akte emërimi nr.106 i datës 10.02.2022 ; Raporti i prezencës në punë për periudhë nga data 01.08.2020 deri me datës 28.02.2021 prej 1/5 faqe; Kërkesë e datës 15.03.2022 nga KPMSHC-së dërguar Njësisë së personelit në Ministri të Shëndetësisë, për tu përgjigjur në ankesë të ankuesit sipas kërkesës së datës 18.02.2022 nr. protokollit 886/2022 ; E-

mail i datës 25.03.2022 i protokolluar me datë 25.03.2022 nr. 1599/2022, sipas kërkesës (E-mailit) së datë 15.03.2022 të KPMSHCK-së, me provat e bashkangjitura, Vendim Nr. 615/2020 i datës 16.07.2020; Vendim Nr. 614/2020 i datës 16.07.2020; Vendim Nr. 617/2020 i datës 16.07.2020; Vendim Nr. 618/2020 i datës 16.07.2020; Vendim Nr. 619/2020 i datës 16.07.2020; Vendim Nr. 620/2020 i datës 16.07.2020; Vendim Nr. 621/2020 i datës 16.07.2020; Vendim Nr. 628/2020 i datës 16.07.2020; Vendim Nr. 629/2020 i datës 16.07.2020; Vendim Nr. 630/2020 i datës 16.07.2020; Vendim Nr. 631/2020 i datës 16.07.2020; Vendim Nr. 632/2020 i datës 16.07.2020; Vendim Nr. 626/2020 i datës 16.07.2020; Vendim Nr. 623/2020 i datës 16.07.2020; Vendim Nr. 622/2020 i datës 16.07.2020; Vendim Nr. 624/2020 i datës 16.07.2020; Vendim Nr. 625/2020 i datës 16.07.2020; Vendim Nr. 633/2020 i datës 16.07.2020; Vendim Nr. 616/2020 i datës 16.07.2020; Vendim Nr. 611/2020 i datës 16.07.2020; Vendim Nr. 612/2020 i datës 16.07.2020; Vendim Nr. 613/2020 i datës 16.07.2020; Vendim Nr. 610/2020 i datës 16.07.2020; Vendim Nr. 609/2020 i datës 16.07.2020; Vendim Nr. 627/2020 i datës 16.07.2020; Vendim Nr.93/17 i datës 23.08.2020; Vendim Nr.protokolli 05-3750 i datës 26.06.2020; Vendim Nr.protokolli 05-3749 i datës 26.06.2020; Vendim Nr.protokolli 05-3752 i datës 26.06.2020; Vendim Nr.protokolli 05-3751 i datës 26.06.2020; Vendim i datës 16.06.2020 prej 1/6 faqe; Vendim Nr.protokolli 05-3517 i datës 16.06.2020; Vendim Nr.protokolli 05-3818 i datës 16.06.2020; Vendim Nr.protokolli 05-3819 i datës 16.06.2020; Vendim Nr.protokolli 05-3520 i datës 16.06.2019; Vendim Nr.protokolli 05-3516 i datës 16.06.2020; Vendim Nr.protokolli 05-3514 i datës 16.06.2020; Vendim Nr.protokolli 05-672 i datës 14.02.2019; Listën e pagave për muajin tetor dhe dhjetor të vitit 2020; Raportin e prezencës në punë për periudhën 01.08.2020-28.02.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosjen e kësaj çështje, duke u bazuar në nenin 16 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e parashtruara të lëndës dhe ka konstatuar se janë përmbushur kushtet ligjore për detyrimin e organit punëdhënës, respektivisht udhëheqësin me te lartë administrativ në Ministrinë e Shëndetësisë që t'i ndërmarr të gjitha veprimet ligjore për të vendosur lidhur me kërkesën e datës 12.11.2021 të parashtruar nga ankuesit  
*sepse*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në dëshmitë e ofruara nga organi i punësimit gjegjësisht Akt Emërimin me numër Nr.106 të datës 10.02.2012 ka konstatuar se ankuesi është në marrëdhënie të punës në Ministrinë e Shëndetësisë dhe i njëjti mban pozitën e punës *Asistent i Teknologjisë Informative*, në Departamentin e Menaxhimit Strategjik.

Kolegji bazuar në shkresat e lëndës ka gjetur se Ministria e Shëndetësisë me Vendimin Nr.600/VII/2020 të datës 07.07.2020, ka themeluar Bordit Qendror për Shkollim Specialistik, përgjegjës për intervistimin e kandidatëve për specializim. Ndërsa duke ju referuar e-mailit zyrtar të datës 08.12.2020, të mbikëqyrësi të drejtpërdrejtë të ankuesit drejtuar udhëheqësit të njësisë për burime njerëzore Kolegji ka gjetur se ankuesi ka qenë i angazhuar në Komisionin intervistues në cilësinë e stafit mbështetës teknik, nga data 20.07.2020 deri me datë 22.10.2020. Sipas dëshmime të ofruara ankuesi ka mbështetur e cila ka qenë në cilësinë e

sekretarisë teknike sipas Vendimit me numër Nr.600/VII/2020 të datës 07.07.2020, për themelimin e Bordit Qendror për Shkollim Specialistik.

Ankuesi me datë 12.11.2021 ka parashtruar kërkesë me numër protokoli 05-7285 të Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë, për kompensimin e pagesës për punë jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës dhe gjatë fundjavës, për periudhën sa ka qenë i angazhuar në mbështetje administrative-teknike të Komisionit Intervistues.

Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë, me datë 12.11.2021 përmes e-mailit zyrtar ka obliguar zyrtarin përgjegjës të njësisë për burime njerëzore që të adresoj kërkesën me numër protokoli 05-7285 të datës 12.11.2021 në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në provat e lëndës ka konstatuar Njësia për Burime Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë nuk e ka adresuar dhe rrjedhimisht shqyrtuar kërkesën me numër protokoli 05-7285 të datës 12.11.2021 të parashtruar nga ankuesi, respektivisht nuk ka ndërmarrë asnjë veprim juridik për të proceduar dhe adresuar kërkesën për realizimin e të drejtës së pretenduar për kompensimin e pagesës për punë jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës dhe gjatë fundjavës sipas urdhrimit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se zyrtari përgjegjës i Njesisë për Burime Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë me rastin e mos adresimit dhe rrjedhimisht mos shqyrtimit të kërkesës sipas urdhrimit të Sekretarit, ka vepruar në kundërshtim me nenin 26 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili përcakton se: *Zyrtari publik ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesi, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, përkatësisht dispozitat e nenit 19 ku përcaktohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave*, ndërsa me dispozitat e nenit 20 të Ligjit Nr.06/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, janë përcaktuar rastet se kur nëpunësit civile kanë të drejtë të marrin kompensim të pagës: *1.Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin kompensim të pagës në këto raste: 1.1. kompensim për punë jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës; 1.2. kompensim për punë jashtë orarit gjatë fundjavës, ..., po ashtu me nenin 21 të këtij ligji është paraparë kompensimi me pagesë ose me kohe të lirë për punë jashtë orarit. Ndërsa me dispozitat e nenin 11 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve, është përcaktuar procedura dhe mënyra e kompensimit të nëpunësve civil për punën jashtë orarit.*

Andaj, duke marr parasysh rrethanat si me lartë, Kolegji konstaton se Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, është i obliguar që të ndërmarr veprime ligjore për shqyrtimin e kërkesës të datës 12.11.2021 të parashtruar nga ankuesi në mënyrë që të vërtetojë drejtë gjendjen faktike dhe rrjedhimisht të nxjerr akt administrativ në pajtim me dispozitat e Ligjit

Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.06/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil si dhe Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë.

Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.98/2022.

Zyle Millaku Gojnovci

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesionale

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankauesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Shëndetësisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.